# R E F E R A T

PËR ZGJEDHJEN E NJË **ASISTENTI** NË FUSHËN E HISTORISË NË FAKULTETIN FILOZOFIK NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Në bazë të konkursit të hapur nga Universiteti i Tetovës për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve, me datë 28 nëntor 2020 në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës (www.unite.edu.mk), si dhe në gazetat ditore "Koha" dhe "Sloboden Peçat" është shpallur Konkurs për zgjedhje të një asistenti për lëndët mësimore në fushën e historisë. Në bazë të Konkursit në fjalë, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Filozofik i Universitetit të Tetovës në mbledhjen e tij të mbajtur më datë 11 dhjetor 2020 (Nr.16-1023/1), formoi Komision recensues për zgjedhjen e një asistenti në fushën e historisë në përbërje:

1. **Prof. dr. Fehari Ramadani (kryetar),** profesor ordinar në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Tetovë.
2. **Prof. dr. Zeqirja Rexhepi (anëtar),** profesor inordinar në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Tetovë.
3. **Doc. dr. Hiriet Ziberi (anëtar),** docent në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Tetovë.

Komisioni në përbërje të plotë, si më sipër, pasi e kontrolloi materialin e konkursit, titullit të lartë përmendur i paraqet këtë:

# RECENSION

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar në konkurs, komisioni në fjalë vërtetoi se ka aplikuar vetëm një kandidat, edhe atë:

**Albnora Musa**

Pas shqyrtimit të vëmendshëm të dokumentacionit, Komisioni erdhi në përfundim se kandidatja, Mr. Albnora Musa ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas konkursit dhe i plotëson të gjitha kushtet e parapara në Ligjin për Arsim të Lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovë.

## I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Mr. Albnora Musa ka lindur më 01.04.1991 në Strugë. Në vitin 2009 përfundon me sukses shkollën e mesme në gjimnazin "Dr. Ibrahim Temo" në Strugë, drejtimi i përgjithshëm. Në vitin akademik 2009/2010, i ka filluar studimet në Universitetin e Tetovës, programi studimor histori, të cilat i përfundon me suksesin më të lartë (10.00) dhe më 28.08.2013 merr thirrjen profesor i diplomuar i historisë. Në vitin 2013 regjistron studimet pasdiplomike në Universitetin e Tetovës, Fakulteti filozofik në drejtimin Histori-Koha e Re dhe po ashtu i perfundoi me suksesin maksimal (10.00). Më 13.10.2015, mbron temën e masterit dhe merr gradën Magjistër i Historisë-Koha e re. Në vitin 2017, i vazhdon studimet në ciklin e tretë-doktoraturë, në Institutin e Historisë Nacionale në Universitetin "Kirili dhe Metodij" në Shkup. Kandidatja i ka përfunduar me sukses maksimal (10.00), të gjitha provimet e parapara dhe është duke punuar në tezën e doktoratës.

Mr. Albnora Musa është zgjedhur studente e dalluar e Universitetit të Tetovës në vitin 2013 dhe gjithashtu zgjedhet studente më e mirë e Fakultetit filozofik në nivel shtetëror. Bazuar në suksesin e arritur, në vitin 2013 ajo angazhohet demonstratore në Universitetin e Tetovës në Fakultetin filozofik në programin studimor Histori. Nga viti 2013 deri në 2015 Mr. Albnora Musa ka akumuluar përvojë në cilësinë e demonstratorit në lëndë nga fusha e historisë në Fakultetin filozofik dhe filologjik. Prej vitit 2016 Mr. Albnora Musa punon si bashkëpunëtore e jashtme në Fakultetin filozofik në programin studimor Histori.

Kandidatja për qëllime profesionale në mënyrë aktive shërbehet me gjuhët e huaja: gjuhë angleze dhe maqedonase.

## II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Mr. Albnora Musa ka treguar sukses në rrugën për angazhim potencial akademik duke manifestuar kapacitete adekuate për të zhvilluar mësimdhënie dhe duke nxitur mësimnxënien e studentëve. Që nga viti akademik 2013/2014, e deri tani viti akademik 2020/2021, ka mbajtur ligjërata (nën mbikëqyrje) dhe ushtrime në lëndët: *Shkencat ndihmëse të historisë; Metodologjia e historisë; Historia e Ballkanit XVI-1804; Mitologji; Arkeologji; Bazat e Etnologjisë; Etnologjia Shqiptare I; Etnologjia Shqiptare II; Historia e Mesjetës I dhe II; Historia e Popullit Shqiptar III; Historia Botërore Bashkëkohore I dhe II; Historia e integrimeve evropiane* (Fakulteti filologjik, në programin studimor: Gjuhë dhe letërsi shqipe dhe Gjuhë dhe letërsi maqedonase); *Historia e Përgjithshme* (Pedagogji, drejtimi klasor), *Etnologjia* (në programin studimor të Filozofisë).

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Mr. Albnora Musa ka realizuar gjithsej **62.76** pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

## III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidatja është marrë vazhdimisht me hulumtime shkencore në fushën e historisë. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidates përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore, me pjesëmarrje në tubime shkencore ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare. Kjo veprimtari e kandidates është paraqitur më poshtë.

### A. Artikuj shkencorë:

1. F. Ramadani, **A. Musa**, F. Shabani, *Raportet e Faik Konicës me Austro-Hungarinë (1897-1912)*, Albanologjia-International Journal of Albanology, Vol. 1, Nr. 1-2/2014), (f. 32-40), Tetovë, Maqedoni;
2. F. Ramadani, **A. Musa**, *Qëndrimi i Austro-Hungarisë dhe Italisë ndaj çështjes shqiptare (tetor-nëntor 1912),* Albanologji, vol. II, Nr. 4, 2014,(f. 527-539), Prishtinë, Kosovë;
3. **Albnora Musa**, *Shqiptarët në politikën e Austro-Hungarisë nga Revolucioni Xhonturk deri në prill të vitit 1909*, Albanologji, vol. II, Nr. 7, 2016, (f. 379-393), Prishtinë, Kosovë;
4. **Albnora Musa**, *Kryengritja e vitit 1910 sipas dokumentacionit vjenez dhe qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj saj*, International Scientific Conference "Relations between albanians and Austro-Hungary (Austria) by mid XIX century to our days", 2016, (f. 199-212), Prishtinë, Kosovë;
5. **Albnora Musa**, *Lufta e Parë Ballkanike dhe pasojat e saj për shqiptarët në vilajetin e Manastirit*, Albanologji, vol. II, Nr. 8, 2017, (f. 363-377), Prishtinë, Kosovë;
6. **Albnora Musa**, *Sterjo Spasse dhe trajtimi historik në romanin PSE*, Vjetari shkencor 7 i Fakultetit të edukimit dhe filologjisë, Universiteti i Korçës "Fan S. Noli", në proces publikimi.

### B. Pjesëmarrja në Konferenca

1. F. Ramadani, **A. Musa**, F. Shabani, *Raportet e Faik Konicës me Austro-Hungarinë (1897-1912)*, 27. 09. 2013, Tetovë, Maqedoni.
2. F. Ramadani, **A. Musa**, *Qëndrimi i Austro-Hungarisë dhe Italisë ndaj çështjes shqiptare (tetor-nëntor 1912),* 21-23. 10. 2013, Prishtinë, Kosovë.
3. **Albnora Musa**, *Shqiptarët në politikën e Austro-Hungarisë nga Revolucioni Xhonturk deri në prill të vitit 1909*, Albanologji, 27. 05. 2016, Prishtinë, Kosovë.
4. **Albnora Musa**, *Kryengritja e vitit 1910 sipas dokumentacionit vjenez dhe qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj saj*, Prishtinë, Kosovë.
5. **Albnora Musa**, *Lufta e parë ballkanike dhe pasojat e saj për shqiptarët në vilajetin e Manastirit*, 10-12. 05. 2017, Prishtinë, Kosovë.
6. **Albnora Musa**, *Sterjo Spasse dhe trajtimi historik në romanin PSE*, 2020, Korçë, Shqipëri.

**C. Projekte shkencore:**

**Monumentet dhe identiteti** - Monuments and identity: 01/2012 – 12/2013

**Partnerë në projekt:** OFAJ-DFJW (Paris – Berlin)
CBC – LOJA, Maqedoni
Max Mannheimer Studienzentrum - Dachau - Gjermani
The Historial, Museum of the Great War (Peronne) – Francë
Ambasada e Gjermanisë - Maqedoni
Ambasada e Francës – Maqedoni.

**Part I**: What monuments for what identities? (Cilët monumente për cilët identitete)

What are the criteria of a typology of monuments? (Cilët janë kriteret për tipologjinë e monumenteve). Tetovë, 29.01.2012-02.02.2012

**Part II:** Monuments and identity

"History and memory, identity and responsibility, how are these terms connected to the illustration of historical periods in public places and institutions"
(Si janë të lidhura shprehjet Historia dhe memoria, identiteti dhe përgjegjësia, me ilustrimin e periudhave historike në vendet publike dhe institucionet)

Berlin, 21.02.2013- 26.02.2013.

**Part III:** Monuments and identity (Monumentet dhe identiteti), Paris, 11.12.2013-16.12.2013

'**No more war'** a training organized and led by SCI (Servei Civil Internacional), Catalonia, Spain, September 2013.

**"Balkan 100"** 09/2014-12/2014

**Project partners**: Forum ZDF – Forum Ziviler Friedensdienst e.V. (Macedonia-Serbia)

**Part I** - Balkan 100 a training organized and led by Forum Zdf, Struga, Macedonia, September 2014.

**Part II** - Balkan 100 a training organized and led by Forum Zdf, Novi Pazar, Serbia, October 2014.

**Part III** - Balkan 100 a training organized and led by Forum Zdf, Novi Sad, Serbia, December 2014.

## IV. VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJERË

1. 'History that connects' organized and led by Association of History Education of Macedonia, Mavrovo, Macedonia, 2014.
2. 'Dealing with the past' a training organized and led by Forum Zdf, Bitola, Struga, Macedonia, 2015.
3. 'Create Europe in Diversity' organized and led by Association of History Education of Macedonia, Mavrovo, Macedonia, 2014.
4. 'Oral History' a training organized and led by Forum Zdf, Skopje, Macedonia, 2015.

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës të prezantuar më lartë si dhe nga të dhënat në **Shtojcë,** Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidatja Mr. Albnora Musa në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për

zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), ka tubuar gjithsej **115.96 pikë** nga referencat profesionale dhe me këtë e ka kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen për zgjedhjen dhe i plotëson të gjitha kushtet për zgjedhje në cilësinë e asistentit për lëndët mësimore në fushën e historisë në Fakultetin Filozofik pranë Universitetit të Tetovës.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidates, Komisioni recensues arrin në përfundimin se: Mr. Albnora Musa ka kualitet shkencor dhe profesional dhe sipas ligjit për arsim të lartë si dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës që të zgjedhet në thirrjen që ka konkuruar.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit filozofik të Universitetit të Tetovës që kandidatja Mr. Albnora Musa të zgjedhet **asistente** për lëndët mësimore në fushën e historisë në Fakultetin filozofik në Universitetin e Tetovës.

Tetovë, 2020

**ANËTARËT E KOMISIONIT RECENSUES:**

1. **Prof. Dr. Fehari Ramadani, Kryetar**

   ______________________________

2. **Prof. Dr. Zeqirja Rexhepi, Anëtar**

   ______________________________

3. **Doc. Dr. Hiriet Ziberi, Anëtar**

   ______________________________

## SH T O J C Ë

## PËR RECENSIONIN E ZGJEDHJES PËR NJË ASISTENTI NË FUSHËN E HISTORISË NË FAKULTETIN FILOZOFIK NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

**Kandidati:** Albnora Musa

**Institucioni:** Fakulteti filozofik – Universiteti i Tetovës, Tetovë

**Lëmia shkencore:** Historia

## I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

| Nr. rendor | Emri i aktivitetit: | Pikët |
|---|---|---|
| I.1 | **Mbajtja e ligjëratave** (lëndët në ciklin e parë të studimeve) | **33,60** |
| | Shkencat ndihmëse të historisë, **3+1,** 2 semestra | 4×15×2×0.04=**4,80** |
| | Historia e Ballkanit XVI-1804, **3+1,** 2 semestra | 4×15×2×0.04=**4,80** |
| | Mitologjia, **2+1,** 5 semestra | 3×15×5×0.04=**9,00** |
| | Etnologjia Shqiptare I, **2**+1, 1 semestër | 2×15×1×0.04=**1,20** |
| | Etnologjia Shqiptare II, **2+1,** 1 semestër | 2×15×1×0.04=**1,20** |
| | Bazat e etnologjisë, **3+1,** 1 semestër | 3×15×1×0.04=**1,80** |
| | Arkeologji, **2+1,** 1 semestër | 2×15×1×0.04=**1,20** |
| | Etnologjia (në programin studimor Filozofi), **2+1,** 1 semestër | 2×15×1×0.04=**1,20** |
| | Etnologjia (në programin studimor Pedagogji-Profesional), **2+0,** 1 semestër | 2×15×1×0.04=**1,20** |
| | Historia e integrimeve evropiane (në programin studimor Gjuhë dhe letërsi shqipe), **2+0,** 1 semestër | 2×15×1×0.04=**1.20** |
| | Historia e integrimeve evropiane (në programin studimor Gjuhë dhe letërsi maqedonase), **2+0,** 5 semestra | 2×15×5×0.04=**6,00** |
| I.2 | **Mbajtja e ushtrimeve** (lëndët në ciklin e parë të studimeve) | **27,90** |
| | Shkencat ndihmëse të historisë, 3+**1,** 5 semestra | 1×15×5×0.03=**2,25** |
| | Historia e Mesjetës I, 3+**1,** 2 semestra | 1×15×2×0.03=**0,90** |
| | Historia e Mesjetës II, 3+**1,** 2 semestra | 1×15×2×0.03=**0,90** |
| | Historia e popullit shqiptar III-(1830-1878), 3+**1,** 5 semestra | 1×15×5×0.03=**2,25** |
| | Historia e popullit shqiptar III-(1878-1912) 3+**1,** 5 semestra | 1×15×5×0.03=**2,25** |
| | Historia botërore bashkëkohore I, 3+**1,** 5 semestra | 1×15×5×0.03=**2,25** |
| | Historia botërore bashkëkohore II, 3+**1,** 5 semestra | 1×15×5×0.03=**2,25** |
| | Historia e përgjithshme (Pedagogji; drejtimi klasor), 2+**2,** 5 semestra | 2×15×5×0.03=**4,50** |
| | Historia e Diplomacisë I, 3+**1,** 4 semestra | 1×15×4×0.03=**1,80** |
| | Historia e Diplomacisë II, 3+**1,** 4 semestra | 1×15×4×0.03=**1,80** |
| | Historia e integrimeve evropiane, 3+**1,** 3 semestra | 1×15×3×0.03=**1,35** |
| | Historia e kohës së vjetër I, 3+**1,** 2 semestra | 1×15×2×0.03=**0,90** |
| | Historia e kohës së vjetër II, 3+**1,** 2 semestra | 1×15×2×0.03=**0,90** |
| | Historia e popullit shqiptar deri në shek. XI, 3+**1,** 2 semestra | 1×15×2×0.03=**0,90** |
| | Bazat e Etnologjisë, 3+**1,** 2 semestra | 1×15×2×0.03=**0,90** |
| | Etnologjia shqiptare I, 2+**1,** 2 semestra | 1×15×2×0.03=**0,90** |
| | Etnologjia shqiptare II, 2+**1,** 2 semestra | 1×15×2×0.03=**0,90** |
| I.3 | **Konsultime me studentë** | **1,26** |
| | Shkencat ndihmëse të historisë, **3+1,** 1 semestër | 15×1×0.002=**0.03** |
| | Historia e Ballkanit XVI-1804, **3+1,** 1 semestër | 10×1×0.002=**0.02** |
| | Mitologjia, **2+1,** 5 semestra | 60×5×0.002=**0.60** |
| | Etnologjia Shqiptare I, **2**+1, 1 semestër | 10×1×0.002=**0.02** |
| | Etnologjia Shqiptare II, **2+1,** 1 semestër | 10×1×0.002=**0.02** |
| | Bazat e etnologjisë, **3+1,** 1 semestër | 10×1×0.002=**0.02** |
| | Arkeologji, **2+1,** 1 semestër | 10×1×0.002=**0.02** |
| | Etnologjia (në programin studimor Filozofi), **2+1,** 1 semestër | 15×1×0.002=**0.03** |
| | Etnologjia (në programin studimor Pedagogji-Profesional), **2+0,** 1 semestër | 10×1×0.002=**0.02** |
| | Historia e integrimeve evropiane (në programin studimor Gjuhë dhe letërsi shqipe), **2+0,** 1 semestër | 15×1×0.002=**0.03** |

| | | |
|---|---|---|
| | Historia e integrimeve evropiane (në programin studimor Gjuhë dhe letërsi maqedonase), **2+0,** 5 semestra | 45×5×0.002=**0.45** |
| | | |
| | | |
| **Gjithsej** | | **62.76** |

## II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

| Nr. rendor | Emri i aktivitetit: | Pikët |
|---|---|---|
| II.1 | **Pjesëmarrës në projekte shkencore:** | **15** |
| | **Monumentet dhe Identiteti**, OFAJ-DFJW (Paris – Berlin), CBC – LOJA, Maqedoni, Max Mannheimer Studienzentrum - Dachau – Gjermani, The Historial, Museum of the Great War (Peronne) – Francë, Ambasada e Gjermanisë – Maqedoni, Ambasada e Francës – Maqedoni, 01/2012 – 12/2013 | 5 |
| | **'No more war'** a training organized and led by SCI (Servei Civil Internacional), Catalonia, Spain, September 2013. | 5 |
| | "Balkan 100" 09/2014-12/2014, : Forum ZDF – Forum Ziviler Friedensdienst e. V. (Macedonia-Serbia)<br>**Part I** - Balkan 100 a training organized and led by Forum Zdf, Struga, Macedonia, September 2014.<br>**Part II** - Balkan 100 a training organized and led by Forum Zdf, Novi Pazar, Serbia, October 2014.<br>**Part III** - Balkan 100 a training organized and led by Forum Zdf, Novi Sad, Serbia, December 2014. | 5 |
| | **Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar** | **23.4** |
| II.2 | 1. **Albnora Musa,** Shqiptarët në politikën e Austro-Hungarisë nga Revolucioni Xhonturk deri në prill të vitit 1909, Albanologji, vol. II, Nr.7, 2016, (f. 379-393), Prishtinë, Kosovë. | 6 |
| | 2. **Albnora Musa,** Kryengritja e vitit 1910 sipas dokumentacionit vjenez dhe qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj saj, International Scientific Conference "Relations between albanians and Austro-Hungary (Austria) by mid XIX century to our days", 2016, (f. 199-212), Prishtinë, Kosovë. | 6 |
| | 3. **Albnora Musa,** Lufta e parë ballkanike dhe pasojat e saj për shqiptarët në vilajetin e Manastirit, Albanologji, vol. II, Nr. 8, 2017, (f. 363-377), Prishtinë, Kosovë. | 6 |
| | 4. F. Ramadani, **A. Musa,** F. Shabani, Raportet e Faik Konicës me Austro-Hungarinë (1897-1912), Albanologjia-International Journal of Albanology, Vol. 1, Nr. 1-2/2014), (f. 32-40), Tetovë, Maqedoni. | 5.4 |
| | | |
| II.3 | **Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në përmbledhjen e punimeve të konferencës shkencore** | **1.8** |
| | 5. F. Ramadani, **A. Musa**, *Qëndrimi i Austro-Hungarisë dhe Italisë ndaj çështjes* | 1.8 |

| | | |
|---|---|---|
| | *shqiptare (tetor-nëntor 1912),* Albanologji, vol. II, Nr. 4, 2014,(f. 527-539), Prishtinë, Kosovë. | |
| I.4 | **Pjesëmarrje në takime shkencore me kumtesë** | **4** |
| | 1. **Albnora Musa,** *Veprimtaria e Mit'hat Frashërit në vitet 1908-1910*, Muzeu i Alfabetit, 22.11.2015, Manastir. | 2 |
| | 2. **Albnora Musa,** *Sterjo Spasse dhe trajtimi historik në romanin PSE*, Takim vjetor shkencor në Universitetin "Fan S. Noli", 2020, Korçë. | 2 |
| | | |
| II.5 | **Abstrakte të publikuara në librin e përmbledhjeve të konferencave kombëtare/ndërkombëtare** | **6** |
| | **1.** F. Ramadani, **A. Musa**, F. Shabani, *Raportet e Faik Konicës me Austro-Hungarinë (1897-1912)*, 27. 09. 2013, Tetovë, Maqedoni. | 1 |
| | **2.** F. Ramadani, **A. Musa**, *Qëndrimi i Austro-Hungarisë dhe Italisë ndaj çështjes shqiptare (tetor-nëntor 1912),* 21-23. 10. 2013, Prishtinë, Kosovë. | 1 |
| | **3. Albnora Musa**, *Shqiptarët në politikën e Austro-Hungarisë nga Revolucioni Xhonturk deri në prill të vitit 1909*, Albanologji, 27. 05. 2016, Prishtinë, Kosovë. | 1 |
| | **4. Albnora Musa**, *Kryengritja e vitit 1910 sipas dokumentacionit vjenez dhe qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj saj*, Prishtinë, Kosovë. | 1 |
| | **5. Albnora Musa**, *Lufta e parë ballkanike dhe pasojat e saj për shqiptarët në vilajetin e Manastirit*, 10-12. 05. 2017, Prishtinë, Kosovë. | 1 |
| | **6. Albnora Musa**, *Sterjo Spasse dhe trajtimi historik në romanin PSE*, 2020, Korçë, Shqipëri. | 1 |
| **II** | **Gjithsej (II.1-II-5):** | **50.2** |

## III. VEPRIMTARI PROFESIONALE-APLIKATIVE

| Nr. rendor | Emri i aktivitetit: | Pikët |
|---|---|---|
| **III.1** | Përkushtoju së ardhmes, promovim i programeve studimore të USHT, para maturantëve në shkollat e mesme të Strugës, 2015 | **1** |
| **III.2** | Përkushtoju së ardhmes, promovim i programeve studimore të USHT, para maturantëve në shkollat e mesme të Strugës, 2019 | **1** |
| **III.3** | Pjesëmarrje në promovimin e programit studimor Histori | **1** |
| **III** | **Gjithsej (III.1-III.3):** | **3** |

| REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE | Pikët |
|---|---|
| **VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE** | 62.76 |
| **VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE** | 50.20 |

| | |
|---|---|
| **VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE** | 3.00 |
| **Gjithsej** | **115.96** |

Tetovë, 2020

**ANËTARËT E KOMISIONIT RECENSUES:**

1. **Prof. Dr. Fehari Ramadani, Kryetar**

   ______________________________

2. **Prof. Dr. Zeqirja Rexhepi, Anëtar**

   ______________________________

3. **Doc. Dr. Hiriet Ziberi, Anëtar**

   ______________________________

# R E F E R A T

*për zgjedhjen për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe në thirrrje të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës*

Në bazë të nenit 1 të Vendimit për formimin e komisionit recenues me me nr. 16-1027/1 të datës 11.12.2020 nga Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik nga mbledhja e mbajtur më 11.12.2020, në përbërje të: *Prof.Dr Lulzim Murtezani-kryetar, Doc.Dr Ibrahim Neziri-anëtar dhe Doc.Dr Sheruze Osmani Ballazhi-anëtar*, në lidhje me konkursin për zgjedhje-rizgjedhje të shpallur me datën 03.12.2020 në gazetën "*Koha*", "*Слободен печат*" dhe në Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës (www.unite.edu.mk/konkurse) për zgjedhje-rizgjedhje të një asistenti për lëndët mësimore në fushën e psikologjisë, komisioni recenzues pas shqyrtimit të dokumentacionit për aplikim, konstatoi se:

I. Në konkursin për zgjedhje të një asistenti në fushën e psikologjisë është paraqitur (një kanditat), si vijon:
   A. Naser Ramadani, i lindur më 12.09.1993 në Tetovë, komuna e Zhelinës, me shtetësi: Republika e Maqedonisë së Veriut, me numër aplikimi 04-01-1/16 të datës 03.12.2020

Pas shqyrtimit të fletëaplikimit sipas kreut I pika A, komisioni recenzues, më poshtë paraqet këtë përshkrim:

**Kandidati IA: Naser Ramadani**

**IA.1 Të dhëna biografike për kanditatin**

1. **Naser Ramadani,** u lind më 12.09.1993 në Tetovë, me vendbanim në Trebosh-Komuna e Zhelinës, Republika e Maqedonisë së Veriut.
2. Më 04.07.2017, ka përfunduar studimet në ciklin e parë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin Filozofik, programi: Psikologji, me gjithsej 240 ECTS dhe notë mesatare 8.09, duke fituar thirrjen: Psikolog i diplomuar (Diploma e lëshuar më: 14.02.2018).
3. Më 02.11.2020, ka përfunduar studimet e ciklit të dytë, në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin Filozofik, programi: Psikologji, drejtimi: Psikologji organizative, me gjithsej 60 ECTS dhe notë mesatare 9.90, duke fituar thirrjen: Magjistër i psikologjisë-psikologji organizative me temë: "Profili i strokeve, dominimi i ego-gjendjes dhe stili i driverit të punonjësve në vendin e punës" (Certifikata e diplomës e lëshuar më 18.11.2020)

**IA.2 Të dhëna për përvojën e punës**

1. Në bazë të vërtetimit nr. 03-3250/1 të datës 27.11.2020 vërtetohet se Naser Ramadani është i angazhuar në Universitetin e Tetovës në programin studimor: Psikologji-Fakulteti Filozofik si bashkëpuntor me kontratë, që nga viti akademik 2017/18.

2. Në bazë të Vërtetimit nr. 03-3251/1 të datës 27.11.2020, vërtetohet se Naser Ramadani prej 01.01.2019 është i angazhuar me kontratë në Sektorin për veprimtari arsimore në Universitetin e Tetovës.
3. Në bazë të vërtetimit nr. 02-3253/2 të datës 27.11.2020, vërtetohet se Naser Ramadani ka qenë pjesë e komisioneve për rangim të studentëve dhe provimeve pranues në ciklin e parë të studimeve në Universitetin e Tetovës.
4. 2018-2019 Kandidati ka qenë i angazhuar në shkollën fillore "Fan S. Noli"-Trebosh si psikolog shkollor

**IA.3 Të dhëna për pjesëmarrje në projekte dhe trajnime**

1. 2019 / 27-29 mars ka marrë pjesë në trajnimin "Zhvillimi profesional i vullnetarëve të korpusit të paqes dhe homologëve të tyre" Peace Corps, North Macedonia;
2. 2019 / 30.10 - 01.11.2019 është pajisur me Certifikatë trajnimi për kompetenca të caktuara në lidhje me auditim të brendshëm për menaxhimin me sistemet e cilësisë ISO 9001:2015;
3. 2016 / Qershor: është pajisur me Certifiaktë për pjesëmarrje në trajnim në Ohër për temën: "Përpunimi kreativ i konflikteve dhe ndryshimet sociale", nga Center for balkan cooperation – Loja.
4. 2019 / 15-16.11 është pajisur me Certifikatë trajnimi për pjesëmarrje në puntori "Aplikimi i metodave statisiktore në kërkimet shkencore-SPSS";
5. 2016 / 25.05 është pajisur me Certifikatë për 25 orë pjesëmarrje aktive në programin për edukim dhe zhvillim personal "Shkathtësi emocionale" nga Asocijacioni maqedonas për analizë të transaksioneve MATA-Shkup;
6. 2016 / 30-31 maj: është pajisur me Certifikatë pjesëmarrjeje në puntorinë e projektit ""Vlerat demokratike në arsim dhe aplikimi i tyre në shoqëri"-Universiteti i Evropës Juglindore;
7. 2016 / Maj: është pajisur me Certifiaktë për pjesëmarrje në trajnim në Ohër për temën: "Përpunimi kreativ i konflikteve dhe ndryshimet sociale", nga Center for balkan cooperation – Loja.
8. 2020 / 30 Nëntor: ka marrë pjesë në projektin "Gjuha e urrejtjes gjatë kampanjës zgjedhore 2020 në zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Efektet e sjelljeve të qytetarëve në relacionet ndërgrupore", projekt i Universitetit të Tetovës, Qendra për paqë dhe komunikmin transkulturor;
9. 2020 / Pjesëmarrës në zhvillimin dhe standardizimin e testit për interesat dhe orientimin profesional-Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RMV-së (Udhëzues-Doracak);

**IA.4 Të dhëna për pjesëmarrje në konferenca shkencore**

1. 2019 / 13-15 Nëntor: Certifikatë për pjesëmarrje në konferencën e 6-të ndërkombëtare me temë “Migration, Reasons, Motives and Consequences in the Society”-Universiteti i Tetovës;
2. 2015 / 30-31 tetor: Certifikatë për pjesëmarrje në konferencën e 3-të ndërkombëtare shkencore të Fakultetit Filozofik (ICPHF2015)-Universiteti i Tetovës;
3. 2018 / 26-28 tetor: Abstrakt i botuar në konferencën ndërkombëtare për biznes dhe teknologji në UBT, me temë “The Dominance of the Ego-States and the Level of Teacher’s Efficacy in the Working Environment”, Ibrahim Neziri (1), Naser Ramadani (2), faqe 462.
4. 2019 / 13-15 nëntor: Abstrakt i botuar në kongresin ndërkombëtar për shkencat humane, sociale dhe arteve në Universitetin e Tetovës, me temë “Using moral attitudes in the view of utilitarianism and defining the stages of moral development according to Kohlberg”, Kushtrim Ahmeti (1), Naser Ramadani (2), faqe 263.

**IA.5 Të dhëna për botime shkencore**

1. Neziri I,. and Ramadani N,. (2019). The dominance of the ego-states and the level of teacher’s efficacy in the working environment, PHILOSOPHICA, International Journal of Social and Human Sciences, 6 (11-12). pp. 14-21. ISSN 2671-3020.
2. Ahmeti, K dhe Ramadani N,. (2019). Using moral attitudes in the view of utilitarianism and defining the stages of moral development according to Kohlberg, PHILOSOPHICA, International Journal of Social and Human Sciences. Vol. 7 No. 13-14 (2020), ISSN 1857-9272.

**II. Përfundim**

Në bazë të kreut I ky referat përmbyllet me recenzimin e një kanditati. Sipas përshkrimit të lartëshënuar për kanditatin nga kreu I i këtij referati dhe kushteve për zgjedhjen e bashkëpunëtorit sipas konkrusit, kanditati IA Naser Ramadani, në dokumentacionin e dorëzuar me fletëpaplikimin nr. 04-01-1/16 të datës 03.12.2020, i plotëson kriteret ligjore sipas nenit 170 të Ligjit për arsim të lartë të RMV-së (18/2018) dhe i posedon të gjitha dokumentetet e kërkuara:

- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet me gjithsej 300 ECTS dhe notë mesatare të përshtatshme;
- Kontinuitet në studimet e ciklit parë dhe dytë nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër (CV);
- Punimin e magjistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve dhe certifikatë të shtetësisë

**III. Propozimi i komisionit recenzues**

Në bazë të verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit dhe kushteve të kërkuara për zgjedhjen në thirrjen e bashkëpunëtorit në Fakultetin Filozofik - Universiteti i Tetovës: një asistent për lëndët mësimore në fushën e psikologjisë dhe në bazë të kritereve të caktuara në nenin 170 të Ligjit për arsim të lartë të RMV-së (18/2018), komisioni recenzues i propozon Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik:

- Kanditati **Mr.sc Naser Ramadani** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore Asistent në lëndët mësimore në fushën e psikologjisë.

**Tetovë, dhjetor 2020** **Komisioni:**

**Prof. Dr. Lulzim Murtezani – kryetar** _______________

**Doc. Dr. Ibrahim Neziri - anëtar** _______________

**Doc. Dr. Sheruze Osmani - anëtar** _______________